# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443850**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘Territorialja’/ Komisioni i ngarkuar nga Këshilli përgatit relacionin kundër shkrirjes së Bashkisë Divjakë, zhvillohen dëgjesa me qytetarët - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/territorialja-komisioni-i-ngarkuar-nga-keshilli-pergatit-relacionin-kunder-shkrirjes-se-bashkise-divjake-zhvillohen-degjesa-me-qytetaret` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 16:41:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 16:36:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 2538873b3db29a861a80180f6488be64059b5e3e461f6961712cda08e24d6b42 |
| TEKSTI | 56963f728076a8424ebdff02210783aa91d99254ba52fe43804c15341ebc391b |
| PAMJA | a3bf72866d7e54c40ad0e91f05265d260fa264ab23c6bcde148c94b78cbd98cc |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 9bf40053f3670515fbef084cd4a304848e7176cb7ad6345126e9e12dd2fcc6f2 |
| E MËPARSHMJA | 61132e8d3b8a1e510880715a4f56237a73a7db20b070db39615ac1b27cc44670 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9bf40053f3670515fbef084cd4a304848e7176cb7ad6345126e9e12dd2fcc6f2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Arrestohen 2 rusët dhe ukrainasi që sulmuan ushtarët në Uzinën e armëve në Gramsh! Dyshohet se janë agjentë të shërbimeve sekrete

Politikë

# 'Territorialja'/ Komisioni i ngarkuar nga Këshilli përgatit relacionin kundër shkrirjes së Bashkisë Divjakë, zhvillohen dëgjesa me qytetarët

*Kryetari i Bashkisë Divjakë, zoti Josif Gorrea, ka informuar pjesëmarrësit me relacionin e përgatitur nga komisioni, material i cili do të paraqitet në Kuvend për të kundërshtuar projektin territorial për shkrirjen e Bashkisë Divjakë me Lushnjën.*



*Dëgjesa për 'Territorialen' në Divjakë*

[Sh].com Redaksia
14 Shtator, 18:33 | **Përditësimi: 14 Shtator, 18:36**

Share Tweet

Komisioni i ngarkuar nga Këshilli Bashkiak i Divjakës për të përgatitur relacionin kundër shkrirjes së Bashkisë [Divjakë](), pas një muaji punë dhe argumentesh, ka dalë në terren për të marrë edhe mendimet e qytetarëve në [dëgjesa publike]().

Dëgjesa e parë është organizuar në Divjakë, ku, përveç komisionit, salla ishte mbushur nga qytetarë të interesuar.

Takimi fillimisht ka qenë me tone të ashpra, pasi disa nga pjesëmarrësit kanë kërkuar që të kishte prezencë të deputetes së zonës dhe përfaqësues nga hartuesit e Reformës Territoriale.

[Sh].com



LEXO EDHE:
**'Muzak Fest' rikthen artin në Apoloni! Emra të njohur të skenës shqiptare bashkojnë poezinë, muzikën dhe historinë**

Kryetari i Bashkisë Divjakë, zoti Josif Gorrea, ka informuar pjesëmarrësit me relacionin e përgatitur nga komisioni, material i cili do të paraqitet në Kuvend për të kundërshtuar projektin territorial për shkrirjen e Bashkisë Divjakë me Lushnjën.

Ndër të tjera, Gorrea ka renditur faktet, të cilat sipas tij janë një armë e fortë që Kuvendi të mos miratojë shkrirjen e Bashkisë Divjakë.

Edhe nënkryetari i Këshillit Bashkiak, përfaqësues i opozitës, Eugen Verdho, u shpreh se opinionet e



qytetarëve do të gjejnë vend në materialin e komisionit për të mbrojtur pozitat e Divjakës si bashki.

Disa nga pjesëmarrësit që shprehën mendimet dhe argumentet e tyre janë të gjithë kundër shkrirjes së Bashkisë Divjakë, duke bërë edhe thirrje që në protestën që mbahet prej 45 ditësh të jetë e pranishme, për t'i mbështetur, edhe administrata, fermerët dhe bizneset.

Dëgjesat do të vazhdojnë edhe në njësitë administrative ditët e ardhshme.

R.Xh/Shqiptarja.com

**TAG:** reforma territoriale | lushnje | Fier | divjakë | harta teritoriale | degjesa publike

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18
**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Aksident në Fier-Seman, makina del nga rruga dhe përfundon në kanal, plagoset shoferja (EMRI)**
20 Shtator, 12:25



**Tjetërsimi i tokës në Seman, lihen në burg ish-drejtorët e Kadastrës! 'Arrest shtëpie' biznesmenit**
19 Shtator, 17:50



**Kaloi rininë në internim, poeti vlonjat Neki Ngucaj zgjedh bibliotekën e Lushnjës për të promovuar 16 librat e tij**
19 Shtator, 16:26



**Fier/ U dogjën 500 ha ullishte dhe 15 objekte, numri 2 i policisë: Shkak transformatori i OSHEE! 41 të arrestuar për zjarret e qëllimshme, shumica mbi 70-vjeç (VIDEO)**
Marsela Topi
19 Shtator, 15:58



**Mbahet në Toshkëz të Lushnjës, 'Festa e vreshtarisë'! Tradita dhe puna e fermerëve në një panair**
Yrjet Saliasi
19 Shtator, 15:52



**Aksident në aksin Fier–Patos, makina përplaset me motorin e shpërndarësit të picave! Plagoset drejtuesi (VIDEO)**
19 Shtator, 13:45



**Pas Semanit, ish-drejtori i Kadastrës së Fierit dyshohet se tjetërsoi edhe 71.7 hektarë tokë në Levan, i sekuestrohen 716 mijë euro! Gjykata e lë në burg**
19 Shtator, 11:19



**Përfshihet nga flakët Benzi në Fier, tymi mbulon parkimin nëntokësor (VIDEO)**
18 Shtator, 11:37



**Parkimet e gabuara/ Rrugorja e Fierit monitorim me dron për shkelësit e qarkullimit (VIDEO)**
18 Shtator, 11:17



**Kontrolle intensive të policisë rrugore në rrugët e Fierit, 694 gjoba për shpejtësi në një javë! 7 drejtues mjetesh nën hetim, 2 në pranga**

17 Shtator, 16:04



**Plagosi babanë e ish-partneres, Gjykata e Fierit lë në burg dajën e deputetes së PS (VIDEO)**

17 Shtator, 11:18



**Fier, zbulohet skema e tjetërsimit të 1143 hektarë tokë në Seman, në pranga dy ish-drejtorët e Kadastrës dhe 'pronari'! Sekuestrohet toka dhe 150 mijë euro**



Marsela Topi

17 Shtator, 10:15



[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.